

të gjallë. Civilët e armatosur serb e kishin ndaluar Palin dhe Mahirin në rrugë të fshati Tërstenik/Trstenik dhe i kanë çuar në stacionin policor. Atje i kanë marrë në pyetje dhe i kanë rrahur. Diku nga mesnata, policia i ka liruar, por shumë shpejt ata u arrestuan sërish. Kësaj radhe policia u ka urdhëruar që duhej të lajmëroheshin rregullisht dhe të bashkëpunonin me polici. Pasi që u liruan, ata shkuan në Jabllanicë/Jablanica. Nga ai fshat, Mahiri ka shkuar me një grup pjesëtarësh të UÇK-së në Shqipëri për një ngarkesë të re të armatimeve, ndërkaq Pali i ka thënë se do të rrinte me disa miq. Pas përfundimit të luftës, te babai i Palit kishte ardhur një njeri, i cili i ka treguar se ka qenë në burgun e UÇK-së në Jabllanicë/Jablanica, në kohën kur atje mbaheshin edhe Pali dhe Skënder Kuqi [të shikohet regjistrimi në faqen 145]. Ka thënë se Pali e kishte këmbën e thyer nga keqtrajtimet fizike, sepse UÇK-ja dyshonte se ai punonte për palën serbe. Herën e fundit e kishte parë Palin më **25.07.1998**, kur ky dëshmitar u lirua nga paraburgimi i UÇK-së. Për një kohë të gjatë, babai i Palit ka bërë përpjekje të shumta për të ndriçuar fatin e të birit. Tentonte të bisedonte me komandantët e UÇK-së, por ata i thoshin se Pali kurrë nuk ka qenë pjesëtar i UÇK-së. Përfundimisht, më 5.04.2005, Zyra e UNMIK-ut për Persona të Zhdukur e ka njoftuar familjen se kufoma e Palit ishte identifikuar. Atëherë, familja ka mësuar se autoritetet serbe, në shtator të vitit 1998, e kanë gjetur kufomën e Palit në *Liqenin e Radoniqit/Radonjičko jezero* dhe, më pas, e kanë varrosur në fshatin Piskotë/Piskot. Në datën 12.05.2005, familja i ka rivarrosur mbetjet mortore të Palit në varrezat e fshatit Meqe/Meće.

Burimet: deklarata D.K, FDH-29048; ICTY, IT-04-84 (R. Haradinaj dhe të tjerë), aktgjykim, 3.04.2008, FDH-27349; OMPF, *Mbetjet...*, FDH-15297.

Shahin (Ibrahim) Krasniqi

(20.11.1965, shqiptar nga Fshati i Ri i Maxhunajëve/Novo Selo Mandžunsko, komuna e Vushtrrisë/Vučitrn, arsimtar, pjesëtar i UÇK-së) Shahini e ka kryer shërbimin ushtarak në APJ në Vërbas [Vojvodinë] në vitin 1985.

Gjatë shërbimit, u plagos në kazermë. Pas kthimit nga ushtria, kishte probleme me policinë serbe. Punonte si arsimtar i historisë në fshatin Lupç i Epërm/Gornje Ljupçe [Podujevë/Podujevo]. Nga Kosova u largua në vitin 1992 dhe shkoi në Gjermani, ku ka qëndruar deri në vitin 1997. Në Gjermani u inkuadrua në Lëvizjen Kombëtare për Çlirimin e Kosovës. Në gusht të vitit 1997, u kthye nga Gjermania. Me disa miq e themeloi njësitin e UÇK-së në fshatin Bajgorë/Bajgora [Mitrovicë/Kosovska Mitrovica]. Nga ajo ditë, disa herë ka shkuar për në Shqipëri për të transportuar armatime në Kosovë. Në datën **26.07.1998**, e mori rrugën e kthimit nga Shqipëria në Kosovë, së bashku me një grup luftëtarësh të UÇK-së. Bartnin me vete një ngarkesë armatimesh. Në **Kos-hare/Košare** u ndeshën me forcat serbe që menjëherë shtënë drejt tyre. Shahini u plagos rëndë. Bashkëluftëtarët e kanë kthyer në Bajram Curr, ndërkaq më vonë e çuan në spitalin në Tiranë, ku iu nënshtrua intervenimit kirurgjikal. Po atë ditë, ai ndërroi jetë nga plagët vdekjeprurëse. E varrosën në varrezat e Tiranës. Familjarët i kanë transferuar mbetjet e tij mortore në Kosovë më 25.06.2005. Një ditë më vonë, u bë rivarrimi i tij në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në fshatin Stanoc i Epërm/Gornje Stanovce [Vushtrri/Vučitrn].

Burimet: deklarata S.K. FDH-29793; J. Martin-sen, *Regjistr...*, FDH-26092.

Shaban (Ali) Golaj

(9.03.1970, shqiptar nga Gjakova/Đakovica, hidraulik, pjesëtar i UÇK-së)

Shabani me vëllain Demën dhe familjen e tij jetonin në Gjakovë/Đakovica. Në muajin mars të vitit 1998, u inkuadrua në UÇK. Pas një kohe të shkurtër, u emërua komandant i njësitit të UÇK-së për rajonin e *Rekës së Keqe/Zla reka*. Shabani ka rënë gjatë sulmit të forcave serbe më **26.07.1998**, i cili u zhvillua në mes të fshatrave **Nivokaz**, Dobrosh/Dobroš dhe Junik. Pësoi nga goditja e ciflave të predhës. Po atë ditë, pjesëtarë të UÇK-së e kanë varrosur Shabanin në varrezat e fshatit Sheremetaj/Šeremet.